

L I G J
Nr. 8114, datë 28.3.1996

PËR SPORTIN
(Ndryshuar me ligjin nr. 8650, datë 28.7.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
PËRKUFIZIME

Neni 1

(Ndryshuar paragrafi i shtatë me ligjin nr. 8650, datë 28.7.2000)

Për efekt të këtij ligji:

Veprimtari sportive quhen të gjitha format e veprimtarive fizike e sportive të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes së organizuar a të rastësishme, synojnë shprehjen ose përmirësimin e aftësive fizike e psikike, zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore ose arritjen e rezultateve sportive në garat e të gjitha niveleve, në mënyrë të ndershme, duke respektuar shpirtin sportiv dhe duke vlerësuar ndershmërinë sportive.

Veprimtari sportive quhen veprimtaritë konkrete të zhvilluara në një formë, kohë a vend të caktuar.

Sport amator quhet veprimtaria sportive ku pjesëmarrësit për përgatitjen dhe përfaqësimin në të mbështeten te vullnetarizmi, kurse për shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në vendin e aktivitetit, mbështeten financiarisht nga organizatorët e veprimtarisë.

Sport profesionist quhet veprimtaria sportive ku pjesëmarrësi për përgatitjen dhe përfaqësimin në të trajtohet financiarisht.

Organizatë Sportive Kombëtare (Federatë) quhet organizata që ka si qëllim organizimin, zhvillimin dhe përhapjen e veprimtarive sportive pa qëllim fitimi ekonomik, në një ose disa sporte, dhe që e ushtron këtë veprimtari në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shteti njeh si organizata sportive kombëtare (Federata) vetëm federatat sportive shqiptare.

Organizatat sportive vendore janë klubet ose/dhe shoqatat sportive, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre sportive në një bashki ose komunë të Republikës së Shqipërisë.

Shoqatat sportive janë bashkim vullnetar njerëzish dhe e zhvillojnë veprimtarinë sportive mbi bazë vullnetarizmi.

KREU II
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 2

Veprimtaritë fiziko-sportive janë një e drejtë e të gjithëve pa dallim moshe, seksi, race,

kombësie, niveli shoqëror ose ekonomik, përkatësie fetare a politike e mundësish fizike.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr. 8650, datë 28.7.2000)

Shteti ka për detyrë të nxisë zhvillimin e sportit për të gjithë dhe ndërtimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës sportive.

Shteti financo veprimtaritë sportive të organizatave sportive kombëtare dhe krijon lehtësira fiskale për veprimtarinë ekonomike të tyre, në përputhje me ligjin.

Shteti financo veprimtarinë sportive të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të federatave sportive dhe klubeve sportive, nëpërmjet financimit të projekteve të paraqitura prej tyre, brenda fondeve buxhetore të miratuara me ligj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për Ministrinë Përgjegjëse për Sportin.

Financimi buxhetor i organizatave sportive zbatohet vetëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministri i Financave dhe Ministri Përgjegjës për Sportin.

Neni 4

Ministria e Mbrojtjes, e Brendshme, e Arsimit dhe ajo e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë nxisin zhvillimin e veprimtarisë fizikore-sportive dhe edukimin nëpërmjet saj.

Kriteret e zhvillimit të këtyre veprimtarive përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës të këtyre strukturave.

Neni 5

Pranë strukturës shtetërore të sportit ngrihen organe këshillimore qendrore që funksionojnë mbi bazën e statutit të veçantë të tyre.

Ato janë:

- Këshilli kombëtar i sportit,
- Komisioni kombëtar i sportit të nivelit të lartë,
- Fondi kombëtar i zhvillimit të sportit, të cilët veprojnë mbi bazën e statutit dhe rregulloreve përkatëse.

KREU III

KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

Neni 6

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është organizatë joshtetërore, funksionimi i së cilës mbështetet në Kartën Olimpikë, si dhe në statutin e tij që miratohet nga ministri përgjegjës për sportin.

Neni 7

KOKSH organizon, drejton dhe zhvillon lëvizjen sportive olimpikë, në bashkëpunim me organizatat e tjera sportive kombëtare e lokale.

Shteti njeh vetëm një KOKSH. Asnjë organizatë tjetër sportive nuk mund ta përdorë këtë emër dhe nuk mund të marrë atributet që Komiteti Olimpik Ndërkombëtar i njeh kësaj organizate.

Shteti mbështet financiarisht Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar vetëm për punonjësit që merren me administrimin e tij.

KREU IV FEDERATAT SPORTIVE

Neni 8

Federatat sportive ngrihen e funksionojnë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe kanë statut e rregulloret e tyre të brendshme si dhe grupojnë individë, klube sportive e shoqata sportive të një a më shumë sporteve.

Neni 9

Federatat shqiptare sportive, për veprimtarinë publike që zhvillojnë, janë nën vartësinë e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Ministri përgjegjës për sportin kontrollon zbatimin e politikës shtetërore sportive, plotësimin e detyrave e të të drejtave të deleguara dhe respektimin e kuadrit ligjor (legjislacionit shtetëror) në veprimtaritë dhe administrimin e federatave.

Të gjitha federatat sportive janë të detyruara të bëjnë të njohura vendimet e tyre publikisht.

Në rastet kur vendimi i marrë bie në kundërshtim të hapur me këtë ligj, ministri përgjegjës për sportin ka të drejtë të anulojë zbatimin e tij dhe të marrë masa administrative ndaj personave përgjegjës.

Neni 10

Federatat kanë fuqi disiplinore mbi gjithë anëtarët e tyre dhe kontrollojnë zbatimin e normave të statutit dhe rregullores së brendshme, si dhe të atyre ndërkombëtare, duke u bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës.

Neni 11

Shteti i delegon të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare në sportet përkatëse vetëm një federate sportive, në një sport të caktuar, për një periudhë të caktuar, nëpërmjet miratimit të statutit-tip të federatës nga ministri përgjegjës për sportin.

Miratimi i statutit të federatës është njëherazi edhe autorizim për federatën sportive përkatëse, për të përdorur emrin federata shqiptare e atij sporti.

Në rastet e dy apo më shumë federatave sportive, në të njëjtin sport (në një sport të caktuar), shtetit i lind e drejta që t'ia delegojë këto të drejta federatës sportive që përcaktohet si më e përshtatshme.

Ky përcaktim bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

Neni 12

Vetëm federata sportive e njohur nga shteti si federatë shqiptare ka të drejtën:

- e dhënies së titujve sportivë, kombëtarë.
- e përzgjedhjes së ekipeve kombëtare për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në veprimtaritë zyrtare ndërkombëtare, ku ajo merr pjesë.

- e organizimit në Republikën e Shqipërisë të veprimtarive ndërkombëtare zyrtare në të gjitha nivelet.

Neni 13

Baza e punës së federatave sportive është vullnetarizmi.

Për kryerjen e misionit të tyre ato organizojnë komisione që veprojnë mbi bazën e statutit dhe të rregulloreve të federatave, si dhe të rregulloreve të vetë komisioneve.

Anëtarët pjesëmarrës të këtyre komisioneve paguhën për punën e tyre vetëm për shpenzimet administrative.

Procedura dhe mënyra e pagesës së tyre përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

Federatat sportive kanë të drejtën që, brenda rregullave të miratuara nga asamblетë ose kryesitë (në varësi nga statuti i tyre), të shpërblejnë sportistët cilësorë, të cilët kanë arritur rezultate të shquara sportive, nga fondet financiare që federatat përkatëse disponojnë.

Neni 14

Asnjë federatë tjetër sportive, përveç asaj të njohur nga shteti, nuk ka të drejtë të përdorë në dokumentet e saj emërtimin “Federata shqiptare” ose të japë tituj “Kampion kombëtar i Shqipërisë” a “Fitues i kupës së Shqipërisë”.

Asnjë person fizik a juridik nuk ka të drejtë të organizojë një veprimtari në një sport të caktuar pa marrë paraprakisht miratimin e federatës shqiptare përkatëse të atij sporti.

Kriteret dhe procedurat përkatëse për marrjen e lejes për organizimin e një veprimtarie sportive përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

Neni 15

Federatat sportive mund të përfitojnë ndihmë nga shteti për zhvillimin e veprimtarive të tyre, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Federatat sportive, që përfitojnë ndihmë financiare për personelin administrativ nga buxheti i shtetit, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

Neni 16

KOKSH ka të drejtën për ngritjen e bordit të gjyimit dhe këshillimit, i cili merr në shqyrtim rastet e konflikteve ndërmjet vetë federatave dhe anëtarëve, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit të statuteve dhe të rregulloreve të federatave ose zgjidhjen e konflikteve ndërmjet klubeve dhe pjesëtarëve të tyre.

Ky bord vepron sipas statutit dhe rregullores së saj dhe për këto gjykimi bazohet në:

1. Statutet dhe rregulloret e brendshme të federatave kombëtare.

2. Statutet, rregulloret dhe vendimet e federatave ndërkombëtare, të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe parimet e përgjithshme të së drejtës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare.

Bordi i gjyimit dhe këshillimit sugjeron mënyrën e zgjidhjes së konfliktit nga palët në gjykim.

Procedura e këshillit për palët në konflikt është e detyruar për palët. Federatat sportive janë të detyruara t'i bëjnë të njohura vendimet e bordit të gjyimit dhe këshillimit publikisht, menjëherë nëpërmjet shtypit.

Kur palët nuk janë dakort edhe me vendimin e marrë nga bordi, pas gjyimit të çështjes mund t'i drejtohen gjykatës së zakonshme, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 17

Pjesëmarrja në një veprimtari fizike e sportive të organizuar nga federatat sportive lejohet vetëm për ata ushtrues që janë të pajisur me një certifikatë mjekësore, e cila vërteton se personat ushtrues janë të aftë fizikisht për ta ushtruar atë sport.

Kjo certifikatë për veprimtaritë e organizuara nga federatat shqiptare sportive lëshohet vetëm nga mjekët specialistë sportivë të njohur nga këto federata.

Për veprimtaritë sportive masive certifikatat mund të lëshohen edhe nga mjekët e përgjithshëm.

Mosrespektimi i këtyre normave dënohet sipas sanksioneve në dispozitat përfundimtare të këtij ligji.

Për personat me aftësi të kufizuara fizike e mendore (handikapatët) federatat përkatëse, në bashkëpunim me KOKSH, organizojnë gara të veçanta për nxitjen dhe integrimin e këtyre personave në jetën shoqërore.

Neni 18

Pranë ministrisë përgjegjëse për sportin është Qendra Kërkimore Shkencore.

Qëllimi i Qendrës Kërkimore Shkencore është që në kuadrin e institucioneve kërkimore ekzistuese të nxitë, përhapë e zhvillojë kërkimet shkencore bazë dhe të aplikuara në fushën e edukimit fizik e të sporteve në Shqipëri.

KREU V KLUBET DHE SHOQATAT SPORTIVE

Neni 19

(Ndryshuar me ligjin nr. 8650, datë 28.7.2000)

Klubi sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqatë ose si shoqëri tregtare.

Klubi ose shoqata sportive ndërtohet dhe funksionon si shoqatë sportive në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Klubi sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Klubi sportiv mund të transformohet nga shoqatë sportive në shoqëri tregtare vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të tij, në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë Përgjegjëse për Sportin.

Vetëm klubet sportive që funksionojnë si shoqëri tregtare kanë të drejtë të kenë si qëllim fitimin në veprimtarinë e tyre sportive.

Një shoqatë sportive ka të drejtë të jetë ortak në krijimin e një shoqërie. Shoqëria e krijuar me ortak me një shoqatë sportive, quhet shoqëri sportive mikse dhe regjistrohet në federatën përkatëse. Pjesa e fitimit e shoqatës si ortak në shoqërinë sportive mikse investohet përsëri në veprimtarinë sportive të shoqërisë.

Kur shoqëria tregtare sportive mikse merr emrin e shoqatës sportive që hyn si ortak, ky emër mbetet pronë e shoqatës sportive në rastin e shpërbërjes së shoqërisë ose të daljes së shoqatës nga shoqëria tregtare.

Neni 20

Burimet e financimit të klubeve sportive

Klubet sportive mund të përfitojnë ndihmë:

- nga pushteti lokal;
- nga pushteti qendror;
- nga llotaritë sportive të organizuara nga qendra e llotarive sportive;
- nga persona fizikë a juridikë në formën e sponsorizimit.

Neni 21

Shoqatat sportive janë shoqata pa qëllim fitimi me synim ushtrimin e sportit, si pasojë e bashkimit të disa personave mbi bazën e vullnetarizmit.

Ato ndërtohen dhe funksionojnë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sportive në nivelin lokal, në një a disa lloje sporti, me lejen e organeve të pushtetit lokal. Për njohjen e tyre zyrtare dhe procedurat e regjistrimit ministri përgjegjës për sportin nxjerr akte të veçanta.

Për pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive kombëtare shoqatat sportive janë të detyruara të regjistrohen si anëtare në njërën nga federatat sportive përkatëse, në përputhje me statutet dhe rregulloret e këtyre federatave.

KREU VI TË DREJTAT E SPORTISTËVE DHE TRANSFERIMI

Neni 22

Ushtruesit e veprimtarive sportive në kuadrin e klubit, anëtarë të federatës sportive, kanë të drejtë të zhvillojnë veprimtari sportive në përbërje të atij klubi sportiv që ata zgjedhin.

Ata janë të detyruar të zbatojnë rregullat organizative të klubit ku bëjnë pjesë, i cili, në rast të kundërt, ka të drejtën e masave disiplinore, financiare.

Mënyra e lëvizjes së tyre përcaktohet me rregulloret e federatës sportive përkatëse, të cilat ata janë të detyruar t'i respektojnë.

Neni 23

Do të konsiderohen profesionistë të gjithë ushtruesit e veprimtarisë sportive dhe trajnerët a drejtuesit e klubeve, të cilët kanë një kontratë të rregullt punësimi me klubin sportiv ku bëjnë pjesë, në përputhje me legjislacionin shqiptar të punës.

Veprimtaria e tyre do të bazohet në kontratën e lidhur ndërmjet personave të punësuar në shoqëritë sportive (sportistit, trajnerit, drejtuesit teknik ose pjesëtarit të klubit) dhe klubit ku ata bëjnë pjesë.

E drejta e shfrytëzimit të licencës së sportistit përcaktohet nga kontrata e lidhur ndërmjet palëve, e cila duhet të jetë detyrues në përputhje me kontratën-tip të miratuar nga federata përkatëse sportive.

Në mbështetje të këtij ligji kontratat duhet të jenë të depozituara në federatat përkatëse sportive, mbasi të jenë noterizuar sipas legjislacionit civil shqiptar.

Neni 24

Personat e përmendur në dispozitat e mësipërme (nenet 21, 22), të cilët, për efekt të këtij ligji, do të konsiderohen profesionistë, anëtarë të klubeve sportive (qofshin ato publike, private ose mikse), kanë të drejtë që në përputhje me legjislacionin civil shqiptar të emërojnë një mbrojtës të tyre personal (me prokurë të rregullt), i cili mbron interesat e tyre në lidhje me

marrëdhëniet që ata kanë ose do të kenë me klubin sportiv a federatën sportive, për zgjidhjen e kontradiktave të ndryshme që mund të dalin gjatë ushtrimit të veprimtarisë sportive ose për kontratat e ardhshme që ata do të bëjnë me klubet e ndryshme sportive, brenda a jashtë vendit.

Mbrojtësit e emëruar prej sportistëve duhet të jenë detyrimisht juristë profesionistë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, të cilët kanë të drejtë t'i përfaqësojnë klientët e tyre në të gjitha instancat, qofshin ato shtetërore, gjyqësore, administrative apo të federatave përkatëse sportive, vetëm me paraqitjen e prokurës, që dëshmon autorizimin përkatës.

Neni 25

Do të konsiderohen amatorë të gjithë ata ushtrues të veprimtarisë sportive dhe asaj ndihmëse, të cilët nuk kanë kontratë punësimi me klubin sportiv ku ushtrojnë veprimtarinë dhe që për veprimtarinë e tyre shpërblehen vetëm për shpenzimet administrative më të domosdoshme prej klubit sportiv.

Dispozitat e këtij ligji për lëvizjen e sportistëve profesionistë janë të vlefshme edhe për sportistët amatorë.

Neni 26

Lëvizja e pjesëtarëve të klubit sportiv, anëtarë të federatës sportive, bëhet nëpërmjet kontratës.

Asnjë anëtar nuk ka të drejtë të bëjë një kontratë me një klub sportiv në të njëjtën kohë kur është i lidhur me kontratë me një klub tjetër sportiv.

Ata kanë të drejtën të ndryshojnë anëtarësinë e tyre nga një klub në tjetrin, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bazuar vetëm në kontratën e veçantë, ose në kontratën kolektive, që anëtari ka me klubin sportiv, në përputhje me rregulloret dhe vendimet e federatës sportive përkatëse, duke u konsideruar, sipas legjislacionit shqiptar të punës, si të punësuar në klubin sportiv për profesionistët.

Çdo shkelje e kësaj dispozite dënohet sipas sanksioneve në fund të ligjit.

Neni 27

Menaxherët sportivë

Lëvizjet e sportistëve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të bëhet nga menaxherët, të zgjedhur nga klubet sportive dhe të njohur nga federatat sportive përkatëse, të pajisur me licencë të rregullt, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me rregullat e procedurat e përcaktuara në urdhrin përkatës të ministrit përgjegjës për sportin.

Federatat sportive përkatëse janë të detyruara të zbatojnë dhe të vendosin rregulla e procedura në mbështetje të paragrafit të mësipërm, duke aplikuar sanksione sipas dispozitave në fund të këtij ligji, ndërsa për menaxherët sportivë që i shkelin këto rregulla e procedura, federatat kanë të drejtë të kërkojnë heqjen e licencës së bashku me gjobat përkatëse.

Neni 28

Organi kompetent i federatës gëzon të drejtën e sanksioneve disiplinore të përcaktuara në statutin e federatës për anëtarët e federatës sportive, që nuk respektojnë rregullat e lëvizjes së anëtarëve nga një klub sportiv në tjetrin, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Konflikti lidhur me respektimin e kontratave të ndryshme të parashikuara në këtë ligj do të zgjidhet në gjykatën e rrethit.

Neni 29

Sportisti i zgjedhur në ekipin përfaqësues ka të drejtën e grumbullimit dhe të trajtimit të veçantë për takimet ndërkombëtare zyrtare të të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja e grumbullimit dhe niveli i trajtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Sportisti që përcaktohet si sportist i nivelit të lartë, fiton të drejtën e trajtimit ekonomik e social të veçantë.

Kushtet dhe kohëzgjatja e këtij trajtimi përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Komisioni kombëtar i sportit të nivelit të lartë përcakton kriteret për zgjedhjen e sportistëve të nivelit të lartë dhe, si organ këshillimor, i propozon ministrit përgjegjës për sportin për miratimin e listës së sportistëve të nivelit të lartë një herë në vit.

Neni 31

Çdo person që arrin rezultate të shkëlqyera dhe të vazhdueshme në fushën e sportit, nderohet me urdhrin kombëtar dhe medaljen për “Merita të shquara sportive”.

Kriteret dhe procedura e dhënies së urdhrit dhe niveli i pagesës për të përcaktohen çdo vit nga ministri përgjegjës për sportin, pas marrjen së mendimeve nga organet konsultative.

KREU VII OBJEKTET SPORTIVE, SHFRYTËZIMI, SIGURIMI

Neni 32

Objektet ose mjediset sportive mund të jenë:

- kombëtare,
- bashkiake,
- komunale (të komunës).

Objektet janë private kur ndërtohen tërësisht nga persona privatë.

Përkatësia dhe pronësia e tyre përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Organet qendrore dhe lokale mbështesin dhe nxisin mirëmbajtjen e objekteve dhe mjediseve ekzistuese, si dhe ndërtimin e objekteve sportive të reja nga subjekte publike a private, në përputhje me normat e urbanistikës e të mjedisit dhe dispozitat e tjera.

Organet qendrore dhe lokale mund t’u japin në përdorim, pa lejuar ndryshimin e destinacionit, objekte e mjedise të ndryshme sportive, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, subjekteve të ndryshme publike a private.

Neni 34

Ndalohet ndryshimi i destinacionit të objekteve e mjediseve sportive, duke u

konsideruar ato si objekte të shërbimit publik.

Nuk përbën ndryshim destinacioni organizimi në raste të veçanta i veprimtarive kulturore-artistike ose i tubimeve të ndryshme në objektet dhe mjediset sportive.

Dhënia e lejes së objekteve sportive në këto raste jepen nga personat juridikë që i kanë në përdorim, të cilët duhet të marrin medoemos miratimin e institucionit prej të cilit varen.

Neni 35

Mjediset sportive ndërtohen në përputhje me normat ekzistuese të sigurimit teknik, që në fazën e projektimit dhe strukturimit të tyre.

Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive duhet të garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieniko-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive.

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen kriteret e vlerësimit të përshtatshmërisë dhe tarifave të përdorimit të këtyre objekteve për zhvillimin e veprimtarive sportive, të hapura ose jo për publikun.

Neni 36

Organet shtetërore ose organizatat sportive që i kanë në pronësi a përdorim këto objekte duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të kërkuara nga neni 36 i këtij ligji.

Asnjë person fizik a juridik nuk mund të organizojë një veprimtari sportive në një mjedis sportiv, për të cilin nuk është bërë verifikimi dhe miratimi i kushteve të sigurimit teknik.

Mosrespektimi i këtij neni dënohet sipas dispozitave përfundimtare të këtij ligji.

Neni 37

Organet qendrore dhe lokale sigurojnë për të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve përdorimin e mjediseve sportive, duke u kujdesur për një shfrytëzim të arsyeshëm e të plotë të këtyre mjediseve.

Përdorimi i mjediseve dhe i pajisjeve sportive që i përkasin shtetit, mund të përdoret me pagesë nga ushtruesit.

Në zbatim të kësaj dispozite do të përfshihen edhe objektet sportive të shkollave të ndryshme në varësi të ministrive të tjera, si të Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Brendshme.

Procedura e përdorimit përcaktohet me akte nënligjore.

Objektet sportive të rëndësisë së veçantë (kombëtare) jepen me qira për përdorim të përkohshëm, vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

Neni 38

E drejta e shfrytëzimit të mjedisit sportiv i takon administratorit të tij.

E drejta e shfrytëzimit të veprimtarisë a garës, që zhvillohet në mjedisin sportiv, i përket organizatorit të kësaj veprimtarie.

Marrëdhëniet ndërmjet pronarit a administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të impiantit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet kontratës ndërmjet dy palëve.

Zotëruesi i së drejtës së shfrytëzimit të një veprimtarie a gare sportive nuk mund t'u vërë sportistëve pjesëmarrës në këtë veprimtari a garë sportive, asnjë detyrim që cenon lirinë e

tyre, qoftë atë të të shprehurit apo të çdo lloj lirie tjetër individuale.

KREU VIII E DREJTA E RTV

Neni 39

E drejta radiotelevizive është një shërbim. Personi fizik a juridik që organizon një veprimtari sportive është pronar i të drejtës së transmetimit në radiotelevizion.

Ai mund ta shesë këtë të drejtë brenda apo jashtë territorit të RSH, nëpërmjet kontratës, në përputhje me afatin më të leverdishëm në ankand.

Neni 40

Dhënia e së drejtës për shfrytëzim, të një veprimtarie a gare sportive një shërbimi televiziv, nuk mund të bëhet pengesë për informimin e publikut nga shërbimet e tjera të komunikimit radioteleviziv.

Shitësi a blerësi i kësaj të drejte nuk mund të kundërshtojë difuzionin nga shërbimet e tjera të komunikimit radioteleviziv, të sekuencave të shkurtra të zgjedhura lirisht nga shërbimet që do ta transmetojnë atë.

Këto sekuenca do të transmetohen falas gjatë gjithë emisioneve informative.

Transmetimi i tyre do të shoqërohet dukshëm në të gjitha rastet me një identifikim të dukshëm të shërbimit radioteleviziv, që ka të drejtën e shfrytëzimit të veprimtarisë.

KREU IX REKLAMA DHE SPONSORIZIMI

Neni 41

Federatat, institucionet dhe klubet sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku zhvillojnë veprimtarinë ose garën sportive, për reklamën e shoqërive të ndryshme tregtare, të cilat hyjnë në marrëdhënie kontraktuese me to.

Këtë të drejtë e kanë edhe shoqëritë që administrojnë mjediset sportive, por duke i dhënë gjithnjë përparësi reklamës së firmës që sponsorizon shoqërinë sportive, e cila zhvillon veprimtarinë.

Federatat dhe klubet sportive që organizojnë veprimtarinë sportive, të bëjnë kontratë, për të përcaktuar të drejtat e tyre dhe të administratorit të mjedisit sportiv për shfrytëzimin e sipërfaqeve të dukshme dhe për ndarjen e të ardhurave nga reklamat.

Neni 42

Klubet sportive ose sportistët individë, për sportet individuale, kanë të drejtë të vendosin në veshjet që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive, emrin e firmës që sponsorizon shoqërinë a klubin sportiv, gjithmonë mbi bazën e kontratës dypalëshe të sponsorizimit ndërmjet klubit, federatës a sportistit dhe sponsorizuesit.

Madhësia dhe forma e mbishkrimeve që do të përdoren në këtë rast, do të jenë gjithmonë sipas normave të rregullores së federatës përkatëse sportive, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Në mbishkrimet që do të përdoren për këtë qëllim, lejohen vetëm ato me shkronja latine dhe në gjuhë shqipe.

Çdo shkelje e kësaj dispozite do të dënohet sipas sanksioneve në fund të këtij ligji.

KREU X DHUNA NË SPORT

Neni 43

Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve, ose gjithë transmetimit të tyre në publik a në mjediset ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose tentativa për provokim, me karakter politik, social, racial, fetar ksenofob, që synojnë nxitjen e urrejtjes e dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe ndaj spektatorëve.

Çdo shfaqje e dhunës në kuptimin e saj fizik ose moral (fyerja) në drejtim të gjyqtarit, sportistëve pjesëmarrës në veprimtari dhe spektatorëve, qoftë edhe e ushtruar prej tyre, dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 44

Ndalohet mbajtja dhe përdorimi në mjediset sportive i fishekzjarreve dhe i armëve të të gjitha llojeve.

Shkelja e këtij neni, kur nuk përbën kundërvajtje administrative, dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Ndalohet përdorimi dhe tregtimi i pijeve alkoolike në mjediset sportive.

Personat që veprojnë në kundërshtim me këtë dispozitë dënohen sipas sanksioneve në fund të këtij ligji.

Neni 45

Personi që merr pjesë në veprimtarinë sportive në cilësinë e gjyqtarit, është i paprekshëm.

Ai do të konsiderohet, për efekt të këtij ligji, person zyrtar, përfaqësues i federatës përkatëse sportive.

Çdo cenim a tentativë për cenim të personit që merr pjesë në veprimtarinë sportive me cilësinë e gjyqtarit, qofshin ato morale a fizike, nga personat pjesëmarrës në veprimtarinë sportive apo spektatore, konsiderohet cenim i personit zyrtar dhe ndiqet sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46

Ruajtja e rendit publik në mjediset sportive të hapura për spektatorët është kompetencë e Ministrisë së Brendshme.

Ministria e Brendshme, pas konsultimeve me organet shtetërore të sportit dhe federatat shqiptare të sportit, përcakton kriteret e zbatimit të kësaj dispozite.

Çdo person fizik a juridik që organizon një veprimtari sportive është i detyruar të njoftojë 15 ditë përpara zhvillimit të veprimtarisë organin e Ministrisë së Brendshme, në territorin e të cilit do të zhvillohet veprimtaria.

Në rast të kundërt, organizatorët dënohen sipas sanksioneve të këtij ligji.

KREU XI PËRDORIMI I SUBSTANCAVE DHE METODAVE DOPING-STIMULUESE NË SPORT

Neni 47

Komisioni antidoping shqiptar merret me edukimin, propagandën, luftën dhe kontrollin për antidopingun në sport.

Ky komision e ka selinë në Qendrën Kërkimore Shkencore të Sportit.

Neni 48

Përdorimi dhe shpërndarja e substancave dhe metodave doping të shënuara në listën e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar është i ndaluar për të gjithë pjesëmarrësit në veprimtaritë sportive në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Çdo përdorim i tyre, i substancave dhe metoda doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre, dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranura nga federatat përkatëse, me jo më pak se dy vjet pezullim nga çdo lloj veprimtarie sportive.

KREU XII SANKSIONET

Neni 49

Janë kundërvajtje administrative, kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të mëposhtme të këtij ligji.

- Për shkeljet e nenit 14, paragrafi i dytë, dënimet do të jenë me gjobë 50 000 - 100 000 lekë, në rast përsëritjeje, dënimi do të rritet pesë herë.

- Për shkeljet e nenit 17, dënimet do të jenë për organizatorët e veprimtarive që nuk respektojnë këtë dispozitë me gjobë 25 000 deri 50 000 lekë.

- Për shkeljet e nenit 26, dënimet do të jenë me gjobë 25 000 deri 50 000 lekë.

- Për shkeljet e dispozitave të nenit 27, dënimet do të jenë me gjobë deri 100 000 lekë për sportistët që shkelin kontratat dhe 300 000 lekë për klubet. Për menaxherët ndërmjetës gjobë deri 500 000 lekë deri në heqjen e licencës.

- Për shkeljet e nenit 36 dënimi do të jetë me gjobë 10 000 lekë deri 25 000 lekë.

- Për shkeljet e nenit 41 dënimi do të jetë me gjobë 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.

- Për shkeljet e nenit 46 dënimet do të jenë me gjobë 10 000 deri 25 000 lekë deri me ndalim të ushtrimit të veprimtarisë.

Ankimi kundër vendimeve të dhëna bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

KREU XII AKTET QË SHQUFIZOHEN

Neni 50

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 51

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 1472, datë 18.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

